

PROCESVERBAL

**nga seanca e 9-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 29.07.2024**

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë, nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr.Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr.Dragica Ljubevska, Goran Radunoviq, mr.Ivona Mufisheva, mr.Arben Saiti, Maja Damevska, mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 9-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota „pro“, miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Arsyetim nga SHTR BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes.
2. Të ndryshme.

Pika 1

Z. Petrushevski, shpjegoi se seancat publike në pajtim me Ligjin janë të destinuara për arsyetimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes, dhe meqënëse nuk kishte përfaqësues të pranishëm nga ana e transmetuesit, seancën e deklaroi të mbyllur.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI,d.v.**